



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije



Nr. Prot. 069/B/11

VENDIM Nr. 153

për

‘Analizën e Tregjeve të telefonisë mobile’

Duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/07, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085, Rregullores Nr. 5, për Analizat e Tregut dhe Përcaktimin e Ofruesve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (ART Nr. Prot. 115/1/10), Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART) i përbëre nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj Anëtar
- 4) z. Nijazi Ademaj Anëtar

në mbledhjen e XXIX me radhë datës 29 Nëntor 2011, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ART-së, shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga Departamenti i Telekomunikacionit (DT) për fillimin e procesit të ‘**Analizës së Tregut dhe Definimin e Ofrueseve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT)**’.

Nga diskutimi;

VËREHET se;

Dokumentacioni është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës nacional duke marrë në konsideratë të plotë direktivat, rekomandimet dhe praktikat e mira të shteteve të Bashkimit Evropian dhe nga shtetet e rajonit.

Dokumentet e përgatitura deri më tani përbëjnë bazën e duhur për fillimin e analizës së tregjeve me anën e së cilës ART do të analizoj ecurinë e zhvillimit të tregjeve, vlerësimin se në këto tregje zhvillohet ose jo konkurrence efektive dhe vënien/ tërheqjen e masave rregullatore në tregjet ku vërehet se ka/nuk ka konkurrencë efektive.

E gjitha kjo bëhet në funksion të promovimit dhe liberalizimit të tregut të telekomunikacionit, krijimit të kushteve uniforme për të gjithë akterët në këto tregje dhe për hyrësit e rinj potencial, si dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve.

ATËHERË:

Me qëllim të;

- implementimit të dispozitave të Ligjit të Telekomunikacionit, ndërlidhur me promovimin e investimeve dhe konkurrencës së lirë në tregun e telekomunikimeve në Republikën e Kosovës përmes krijimit të sigurisë ligjore duke definuar kornizën transparente për analizë të tregut, definimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme subjekt i rregullimit 'ex-ante'.
- adaptimit dhe zbatimit të politikave që synojnë të forcojnë liberalizimin e plotë dhe krijimin e një ambienti të hapur dhe konkurrent me qëllim të tërheqjes së investitorëve të huaj dhe përmirësimit të kualitetit të shërbimeve,
- parandalimit të abuzimit të fuqisë së tregut nga ndërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg (FNT),
- realizimit të zgjidhjeve të cilat janë plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, direktivat dhe rekomandimet e BE-së dhe praktikatat e mira të shteteve rajonale dhe ndërkombëtare.

Bordi i ART-së nxjerr këtë,

V E N D I M

- I. Miratimin e fillimit të procesit të analizës së tregut të telefonisë mobile respektivisht nëntregut përkatës të paraqitur si në vijim;
 - a) Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale
- II. Procesi i analizës së tregut fillon me datë; 01 Shkurt, 2012 dhe përfundon me 31 Maj, 2012.
- III. Obligohet Grupi Punues i themeluar me Vendimin Nr. 57 (Ref. ART. Nr. Prot. 001/B/11) për implementimin e pikave I) dhe II) të këtij aktvendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i ART-së.

BAZA LIGJORE;

Vendimi, mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar;

- 1) Nenet, neni 1 paragrafët (1) dhe (2) neni 3 paragrafi (1), neni 4 paragrafët (1) dhe (2), neni 11 paragrafi (7) dhe neni 44 të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-85,
- 2) Nenin 3 të Rregullores Nr. 115/1/10 për 'Analizat e tregut dhe përcaktimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg'

- 3) Pika 3.8.3 e dokumentit Politikat e sektorit të Telekomunikacionit dt. 13.06.2007,
- 4) Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE),
- 5) Udhërrëfyesit të Komisionit Evropian 2002/C 165/03 për analizë të tregut dhe përcaktimit të operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg,
- 6) Rekomandimin e datës 11 shkurt 2003 (2003/311/EC) së bashku me rekomandimin pasues të dt. 17 Dhjetor, 2007 (2007/879/EC),
- 7) Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, dt. 07 Mars, 2002 (Ref. *Framework Directive on a common regulatory framework for electronic communications networks and services*),
- 8) Neneve 20 dhe 22 të Rregullores së Brendshme të ART-së.

Këshilla Juridike

Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative, ndërsa pas plotë fuqizimit të vendimit pala e pa-kënaqur mund të inicioj procedurë gjyqësore tek gjykata kompetente.

Vërtetim

Më këtë vendim konfirmohet se ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me ligjet dhe udhëzimet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, në pajtueshmëri me kontratën dhe rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtinë, 01/12/2011

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

**Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit**

Lulzim Kurtaj Anëtar i Bordit

Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Grupi Punues për Analizë të Tregut
- Operatorëve të rrjetave dhe operatorëve virtual të rrjetave
- Komisionit Kosovar të Konkurrencës
- Arkivit të ART-së